



AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore

Treguesit Statistikorë të Tregut të Komunikimeve Elektronike

Tremujori II 2018

Data e Publikimit: __.__.2018

INDEKSI I PËRMBAJTJES

| | |
|--|----|
| - HYRJE | 3 |
| - TENDENCAT KRYESORE | 4 |
| - TREGUESIT E TREGUT TË SHËRBIMEVE NGA RRJETET CELULARE..... | 4 |
| - TREGUESIT E TREGUT TË SHËRBIMEVE NGA RRJETET FIKSE..... | 12 |

INDEKSI I TABELAVE

| | |
|--|----|
| TABELA 3.1 : NUMRI I PAJTIMTARËVE/PËRDORUESVE CELULARË SIPAS KATEGORIVE | 6 |
| TABELA 3.2: NUMRI I PAJTIMTARËVE TË SHËRBIMEVE CELULARË (KARTA SIM) SIPAS OPERATORËVE..... | 7 |
| TABELA 3.3: NUMRI I PËRDORUESVE AKTIVË TË SHËRBIMEVE CELULARE SIPAS OPERATORËVE.. | 7 |
| TABELA 3.4: NUMRI I PËRDORUESVE AKTIVË TË TELEFONISË CELULARE SIPAS OPERATORËVE ... | 8 |
| TABELA 3.5: NUMRI I PËRDORUESVE TË AKSES BROADBAND NE RRJETET 3G/4G SIPAS OPERATORËVE..... | 8 |
| TABELA 3.6: VOLUMI TOTAL I THIRRJEVE, SMS-VE, TË DHENA DHE PERDORIMI MESATAR MUJOR..... | 9 |
| TABELA 3.7: STRUKTURA E THIRRJEVE DALESE CELULARE TE ORIGJINUAR BRENDA VENDIT SIPAS DESTINACIONIT | 11 |
| TABELA 4.1 : NUMRI I LINJAVE TË PAJTIMTARËVE TË TELEFONISË FIKSE | 12 |
| TABELA 4.2 : NUMRI I PAJTIMTAREVE ME AKSES BROADBAND NGA RRJETET FIKSE | 12 |
| TABELA 4.3 : NUMRI I PAJTIMTAREVE QË KANË AKSES NË SHËRBIME TË INTEGRUARA | 13 |

- Hyrje

Bazuar në përcaktimet e Ligjit 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, dhe Rregullores nr.12, datë 07.04.2010, “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike” e ndryshuar, AKEP mbledh të dhëna periodike statistikore nga sipërmarrësit ofrues të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike në Shqipëri.

AKEP ka filluar të publikojë periodikisht të dhëna dhe tregues statistikorë të tregut të komunikimeve elektronike prej muajit Prill 2009 në faqen web www.akep.al. Periodiciteti i publikimeve dhe treguesit e publikuar kanë evoluar nga raportime vjetore dhe gjashtëmujore në raportime vjetore dhe tremujore duke filluar nga Tremujori 4 2014.

Sipërmarrësit e rrjeteve/shërbimeve të komunikimeve elektronike kanë detyrim ligjor të dërgojnë në AKEP, të raportojnë të dhëna periodike rreth aktivitetit të tyre sipas formularëve përkatës që janë pjesë e Rregullores Nr.12. Informacioni i kërkuar nga AKEP nëpërmjet formularëve të Rregullores shërben për përmbushjen e detyrave funksionale të AKEP, ndër të tjera edhe për publikimin e treguesve për publikun e gjerë nëpërmjet raporteve periodike që evidentojnë treguesit kryesorë të zhvillimit të tregut të komunikimeve elektronike.

AKEP publikon treguesit kryesorë të tregut të komunikimeve elektronike duke marrë në konsideratë si natyrën konfidenciale të një sërë treguesve të raportuar nga sipërmarrësit edhe interesat e publikut për të krijuar një treg të hapur dhe konkurrues. Për këtë arsye shumë tregues paraqiten të agreguar për tregun në tërësi dhe jo sipas operatorëve, ndërsa disa tregues paraqiten edhe sipas operatorëve.

AKEP mundohet që të dhënat e publikuara të jenë të plota dhe të sakta për të garantuar një pasqyrim të drejtë të situatës dhe tendencave të tregut të komunikimeve elektronike në Shqipëri. Megjithatë, në disa raste informacioni i mbledhur mund të mos jetë i plotë për shkak se jo të gjithë sipërmarrësit raportojnë në kohë dhe me cilësinë e duhur të dhënat e kërkuara.

AKEP për të rritur plotësinë dhe saktësinë e informacionit të mbledhur dhe të publikuar bashkëpunon me operatorët gjatë procesit të raportimit të të dhënave nëpërmjet komunikimit në modulën on-line, e-mail dhe telefon, si dhe përdor mekanizmat ligjorë të detyrimit të raportimit të të dhënave si inspektime në terren dhe/ose vendosjen e sanksioneve ligjore për mos-raportim të të dhënave.

Për të rritur cilësinë e informacionit të publikuar si dhe krahasueshmërinë me periudhat e mëparshme, AKEP në disa raste përfshin vlerësime të numrit të pajtimtarëve për operatorët (kryesisht operatorë të vegjël të rrjeteve fikse) që nuk kanë raportuar në periudhën përkatëse duke përdorur numrin e pajtimtarëve të raportuar në periudhat e mëparshme të këtyre operatorëve. Gjithashtu në disa raste AKEP mund të publikojë rishikim të treguesve të publikuar për periudhat e mëparshme për shkak të ndryshimeve të vlerësimeve dhe/ose metodologjisë së përdorur nga AKEP dhe/ose raportimeve të operatorëve. Të tilla raste evidentohen nëpërmjet shënimeve përkatëse të AKEP në publikimin më të fundit të të dhënave/informacionit të tregut.

Të dhënat dhe treguesit e publikuar në këtë raport janë për pesë tremujorët e fundit, si dhe të dhëna vjetore për dy vitet para-ardhëse. Për periudhat më të hershme lexuesi mund t'i referohet publikimeve të mëparshme të AKEP. Norma e ndryshimit të një treguesi me tremujorin para-ardhës paraqitet si **‘Ndryshimi Tremujor’**, ndërsa norma e ndryshimit në terma vjetorë (me të njëjtin tremujor në vitin para-ardhës) paraqitet si **‘Ndryshimi v-m-v’**.

Për shkak të rumbullakimeve të vlerave në disa raste mund të ekzistojë një mospërputhje jomateriale ndërmjet shumës së përbërësve dhe totalit të paraqitur nëpër tabela për tregues të caktuar.

Në Tremujorin e dytë 2018 kanë raportuar rreth 145 sipërmarrës të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike. AKEP dëshiron të falenderojë operatorët që kanë depozituar të dhëna për këtë raport dhe shpreson në bashkëpunimin e vazhdueshëm me të gjithë operatorët për procesin e mbledhjes dhe publikimit të të dhënave statistikore të komunikimeve elektronike në të ardhmen.

AKEP mirëpret sugjerime për të përmirësuar procesin e mbledhjes dhe raportimit të të dhënave statistikore si dhe të publikimeve të AKEP, me qëllim plotësimin e interesit publik për të krijuar një treg të hapur dhe konkurrues të komunikimeve elektronike në Shqipëri, duke ruajtur njëkohësisht konfidencialitetin e të dhënave të publikuar nga AKEP për të shmatur përdorimin e tyre në mënyrë antikonkurruese dhe me praktika tregtare jo të ndershme nga konkurrentët në treg.

Dokumenti në vijim përmban përshkrim të nivelit të treguesve kryesorë në Tremujorin II 2018 (T2 2018) dhe krahasime me periudhat e mëparshme, dhe më pas paraqiten të dhënat statistikore në formë tabelare për shërbimet nga rrjetet celulare dhe nga rrjetet fikse, të shoqëruara dhe me disa shënime për përshkrimin e treguesve dhe mënyrën e matjes së tyre.

- **Tendencat kryesore**

- Numri i pajtimtarëve të shërbimeve celulare sipas kartave SIM në fund të T2 2018 ishte rreth 4,876,526 që përbën një ulje me 5.8% në krahasim me tremujorin e mëparshëm, dhe një ulje me 8.9% në krahasim me T2 2017;
- Numri i përdoruesve aktivë të telefonisë celulare gjatë T2 2018 arriti në rreth 2.7 milionë që përbën një rënie me rreth 5.8 % me T1 2018 dhe rënie me 21.2 % në krahasim me T2 2017;
- Numri i përdoruesve aktivë të aksesit broadband në Internet nga rrjetet celulare në T2 2018 ishte rreth 1.7 milionë që përbën një ulje me 7.4% me tremujorin e mëparshëm, dhe një rënie me 4.5% në krahasim me Tremujorin e dytë 2017.
- Totali thirrjeve dalëse të gjeneruara nga pajtimtarët celularë në Shqipëri në T2 2018 ishte rreth 1.6 miliardë minuta, me një rritje prej 2.1 % në krahasim me tremujorin paraardhës dhe me një rënie prej 8.4% me të T2 2017.
 - o Sasia e thirrjeve drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare (off-net) u rrit me 2.4% në krahasim me T1 2018 dhe u ul me 13.8% në krahasim me një vit më parë në T2 2017;
 - o Sasia e thirrjeve on-net u rrit me 2% në krahasim me T1 2018 dhe pësoi një rënie me 3.3 % në krahasim me T2 2017.
 - o Proporcioni i thirrjeve on-net/off-net në T2 2018 ishte 57%/41% krahasuar me 54%/44% në T2 2017.
- Numri i mesazheve SMS të dërguara nga pajtimtarët e rrjeteve celulare në T2 2018 ishte rreth 314 milion që përbën një rritje me 0.1 % krahasuar me T1 2018 dhe një rënie me 14.8 % me T2 2017;
- Sasia e trafikut data (Internet) në rrjetet celulare gjatë T2 2018 ishte rreth 15 Milion GByte. Një përdorues aktiv i aksesit broadband celular ka përdorur 2.85 GB Internet në muaj në T2 2018, që përbën një rritje me 7.2% në krahasim me T1 2018 dhe një rritje 46.2% krahasuar me T2 2017.
- Konsumi mesatar mujor për përdorues aktiv i shërbimeve celulare gjatë T2 2018 ishte: 197 minuta dalëse, 40 SMS dhe 2.85 GB Internet. Krahasuar me T1 2018, konsumi mesatar i thirrjeve pati një rritje me 8.6 %, konsumi mesatar i SMS-ve dhe konsumi mesatar i internetit pati rritje respektivisht me 6.6 % dhe me 7.2 %.

Shërbimet nga rrjetet fikse

1. Numri i pajtimtarëve të linjave të telefonisë fikse në fund të tremujorit të dytë 2018 ishte rreth 248 mijë, që përbën një rënie me 3.04% në krahasim me T1 2018 dhe një rritje me 0.8% në krahasim me T2 2017. AKEP ka kryer vlerësimin e këtij treguesi për periudhat para T4 2016 për shkak të ndryshimit të përkufizimit të tij në këtë tremujor (për më shumë detaje shiko shënimet në seksionin 4)
2. Numri i pajtimtarëve me akses Broadband në internet nga rrjete fikse në T2 2018 arriti në rreth 320 mijë, që përbën një rritje me 2.1% në krahasim me tremujorin e mëparshëm dhe një rritje me rreth 14.8% në krahasim me të njëtin tremujor në vitin 2017.
3. Numri i pajtimtarëve të rrjeteve fikse që kanë akses në shërbime të integruara (Telefoni/Internet/TV) në fund të 3 muajorit të dytë 2018 arriti në rreth 211 mijë, një rënie kjo me 0.1% në krahasim me T1 2018 dhe rritje me 8.6 % krahasuar me T2 2017.
4. Numri i pajtimtarëve me paketa trefishe (Telefoni, Internet dhe TV) përbën 48% të totalit të pajtimtarëve me paketa të integruara ndërsa 41% janë me paketa “Internet dhe Telefoni” dhe 10% me paketa “Internet dhe TV”.
5. 66% e pajtimtarëve me akses broadband në rrjete fikse në fund të T2 2018 ishin pajtimtarë me paketa të integruara (Telefoni/Internet/TV), ku 32% janë me paketa trefishe (Telefoni, Internet dhe TV).

- Treguesit e tregut të shërbimeve nga rrjetet celulare

Tabela 3.1 : Numri i pajtimtarëve/përdoruesve celularë sipas kategorive

| Numri i pajtimtarëve/përdoruesve celularë sipas kategorive | Numri i pajtimtarëve shërbime celulare | Përdorues aktivë shërbime celulare | Përdorues aktivë Telefoni Celulare | Përqindja e përdoruesve aktivë me parapagim | Përdorues aktivë me akses broadband celular | Përdorues me akses broadband celular dhe telefoni celularë | Përdorues me akses broadband me karta të dedikuara |
|--|--|------------------------------------|------------------------------------|---|---|--|--|
| 2014 | 5,049,109 | 3,527,097 | 3,406,772 | 90.4% | 907,975 | 787,650 | 120,325 |
| 2015 | 4,899,825 | 3,564,605 | 3,442,665 | 92.0% | 1,297,281 | 1,175,341 | 121,940 |
| 2016 | 5,280,990 | 3,490,686 | 3,369,756 | 91.8% | 1,686,354 | 1,565,424 | 120,930 |
| 2017 T2 | 5,351,133 | 3,473,868 | 3,350,196 | 91.9% | 1,823,656 | 1,699,984 | 123,672 |
| 2017 T3 | 5,612,142 | 3,847,960 | 3,718,569 | 92.6% | 2,158,739 | 2,029,348 | 129,391 |
| 2017 T4 | 5,558,492 | 3,625,699 | 3,497,950 | 92.1% | 2,030,978 | 1,798,828 | 127,749 |
| 2018 T1 | 5,179,524 | 2,908,664 | 2,783,721 | 90.5% | 1,880,265 | 1,755,322 | 124,943 |
| 2018 T2 | 4,876,526 | 2,738,647 | 2,615,722 | 89.9% | 1,741,491 | 1,618,566 | 122,925 |
| Ndryshimi tremujor | -5.8% | -5.8% | -6.0% | -0.7% | -7.4% | -7.8% | -1.6% |
| Ndryshim (v-m-v) | -8.9% | -21.2% | -21.9% | -2.2% | -4.5% | -4.8% | -0.6% |

Shënime:

| Treguesi | Referenca ne Formulare/Menyrja e llogaritjes | Pershkrim/Sqarim |
|--|--|---|
| Numri i pajtimtarëve shërbime celulare (karta SIM) | D.10 | Numri total i kartave SIM me parapagim dhe pas-pagim që janë aktivë në rrjetin celular në fund të periudhës së raportimit, pavarësisht nëse kanë kryer komunikim apo jo gjatë periudhës së raportimit. Treguesi përfshin të gjitha kartat SIM që perdoren për shërbime zanore dhe të dhenash, të instaluar në aparate celulare, modem, USB apo pajisje të tjera. Nuk përfshihen kartat M2M. <i>Për periudhat para T4 2016, treguesi është llogaritur nga AKEP si shumë e numrit total të pajtimtarëve të shërbimeve telefonike celulare + numri i përdoruesve akses broadband me karta të dedikuara.</i> |
| Përdorues aktive Shërbime Celulare | D.7 | Numri total i përdoruesve aktivë të shërbimeve celulare në fund të periudhës së raportimit. Përfshihen përdoruesit me parapagim aktivë (komunikim në 3 muajt e fundit) dhe përdoruesit me paspagim (pavarësisht komunikimit ose jo në 3 muajt e fundit). Në këtë zë përfshihen përdoruesit e shërbimeve celulare me karta SIM dhe karta të dedikuara të dhenash (Data Card). <i>Per periudhat para T4 2016, treguesi është llogaritur nga AKEP si shumë e numrit total të përdoruesve aktivë të shërbimeve telefonike celulare + numri i përdoruesve akses broadband me karta të dedikuara.</i> |
| Përdorues aktive Telefoni Celulare | D.7-D.10.2 | Numri total i përdoruesve aktivë të shërbimeve telefonike celulare në fund të periudhës së raportimit. Përfshihen përdoruesit me parapagim aktivë (komunikim ne 3 muajt e fundit) dhe përdoruesit me paspagim (pavarësisht komunikimit ose jo në 3 muajt e fundit). Ne këtë zë përfshihen përdoruesit e shërbimeve celulare me karta SIM telefonike. Nuk përfshihen Data Card. <i>Për T4 2016 dhe T2 2017, treguesi është llogaritur nga AKEP si diferenca e</i> |

| | | |
|--|------------------|--|
| | | <i>D7 me numrin e përdoruesve akses broadband me karta të dedikuara (D.10.2).</i> |
| Përqindja e përdoruesve aktivë me parapagim | D.7.1/D.7 | Numri i përdoruesve aktivë (përdorim në tre muajt e fundit) që përdorin karta rimbushëse për përdorimin e shërbimit celular pjestuar me numrin total të përdoruesve aktivë (D7.1/D7). <i>Për periudhat para T4 2016, treguesi është llogaritur nga AKEP bazuar në numrin e përdoruesve aktivë të telefonisë celulare.</i> |
| Përdorues active të Akses Broadband Celular | D.10 | Numri i pajtimtarëve në rrjetet celulare që kanë përdorur aksesin në Internet me shpejtësi broadband mbi 256 kbps (3G/4G ose me të avancuar) të paktën një herë gjatë periudhës së raportimit. Ky tregues ka kategorinë e përdorimit sipas aparatit telefonik celular, tableta etj me karta SIM (zanore dhe të dhëna) dhe nëpërmjet aksesit me karta SIM të dedikuara për të dhëna (USB, dongles etj). |
| Përdorues akses broadband celular dhe telefoni celulare | D.10.1 | Numri i pajtimtarëve të rrjeteve celulare që kanë përdorur aksesin në Internet në rrjet 3G/4G ose më të avancuar nëpërmjet kartave SIM të telefonit celular. |
| Përdorues akses broadband me karta të dedikuara (Data Card) | D.10.2 | Numri i pajtimtarëve të rrjetit që kanë përdorur aksesin në internet, në rrjet 3G/4G ose më të avancuar, nëpërmjet kartave të dedikuara për të dhëna (DATA CARD të dedikuara) |

Tabela 3.2: Numri i pajtimtarëve të shërbimeve celulare (karta SIM) sipas operatorëve

| Numri i pajtimtarëve të shërbimeve celulare (karta SIM) sipas operatorëve | Total | Telekom Albania | Vodafone Albania | Albtelecom | Plus Communication |
|---|------------------|------------------|------------------|----------------|--------------------|
| 2014 | 5,049,109 | 2,002,981 | 2,012,442 | 688,336 | 345,350 |
| 2015 | 4,899,825 | 1,681,931 | 2,033,573 | 782,566 | 401,755 |
| 2016 | 5,280,990 | 1,697,265 | 2,606,602 | 748,924 | 228,199 |
| <i>2017 T2</i> | <i>5,351,133</i> | <i>1,720,360</i> | <i>2,589,224</i> | <i>775,962</i> | <i>265,587</i> |
| <i>2017 T3</i> | <i>5,612,142</i> | <i>1,742,381</i> | <i>2,836,477</i> | <i>753,289</i> | <i>279,995</i> |
| <i>2017 T4</i> | <i>5,558,492</i> | <i>1,791,473</i> | <i>2,733,771</i> | <i>780,781</i> | <i>252,467</i> |
| 2018 T1 | 5,179,524 | 1,745,326 | 2,679,312 | 754,886 | |
| 2018 T2 | 4,876,526 | 1,640,924 | 2,529,959 | 705,643 | |
| Ndryshimi tremujor | -5.8% | -6.0% | -5.6% | -6.5% | |
| Ndryshim (v-m-v) | -8.9% | -4.6% | -2.3% | -9.1% | |

Tabela 3.3: Numri i përdoruesve aktivë të shërbimeve celulare sipas operatorëve

| Numri i përdoruesve aktivë të shërbimeve celulare sipas operatorëve | Total | Telekom Albania | Vodafone Albania | Albtelecom | Plus Communication |
|---|------------------|------------------|------------------|----------------|--------------------|
| 2014 | 3,527,097 | 1,225,737 | 1,595,839 | 444,207 | 261,314 |
| 2015 | 3,564,605 | 1,224,339 | 1,631,161 | 489,128 | 219,977 |
| 2016 | 3,490,686 | 1,133,323 | 1,730,990 | 445,391 | 180,982 |
| <i>2017 T2</i> | <i>3,473,868</i> | <i>1,134,692</i> | <i>1,670,809</i> | <i>459,526</i> | <i>208,841</i> |
| <i>2017 T3</i> | <i>3,847,960</i> | <i>1,217,901</i> | <i>1,911,234</i> | <i>494,628</i> | <i>224,197</i> |
| <i>2017 T4</i> | <i>3,625,699</i> | <i>1,234,411</i> | <i>1,726,842</i> | <i>458,656</i> | <i>205,790</i> |

| | | | | |
|---------------------------|-----------|-----------|-----------|---------|
| 2018 T1 | 2,908,664 | 1,109,600 | 1,353,473 | 445,591 |
| 2018 T2 | 2,738,647 | 998,580 | 1,313,706 | 426,361 |
| | -5.8% | -10.0% | -2.9% | -4.3% |
| Ndryshimi tremujor | | | | |
| | -21.2% | -12.0% | -21.4% | -7.2% |
| Ndryshim (v-m-v) | | | | |

TABELA 3.3/1: Përqindja e përdoruesve aktivë me parapagim të shërbimeve celulare sipas operatorëve

| Përqindja e përdoruesve aktivë me parapagim sipas operatorëve | Total | Telekom Albania | Vodafone Albania | Albtelecom | Plus Communication |
|---|--------|-----------------|------------------|------------|--------------------|
| 2014 | 90.353 | 91.231 | 93.309 | 78.078 | 89.202 |
| 2015 | 91.999 | 91.173 | 94.952 | 84.791 | 90.472 |
| 2016 | 91.844 | 90.187 | 95.547 | 85.362 | 82.765 |
| 2017 T2 | 91.917 | 89.676 | 95.225 | 85.190 | 92.435 |
| 2017 T3 | 92.642 | 90.290 | 95.815 | 85.923 | 93.189 |
| 2017 T4 | 92.100 | 90.151 | 95.190 | 84.569 | 94.269 |
| 2018 T1 | 90.500 | 89.100 | 93.778 | 84.086 | |
| 2018 T2 | 89.853 | 87.990 | 93.590 | 82.703 | |
| | -0.647 | -1.110 | -0.188 | -1.383 | |
| Ndryshimi tremujor | | | | | |
| | -2.064 | -1.686 | -1.635 | -2.487 | |
| Ndryshim (v-m-v) | | | | | |

Tabela 3.4: Numri i përdoruesve aktivë të telefonisë celulare sipas operatorëve

| Numri i përdoruesve aktivë të telefonisë celulare sipas operatorëve | Total | Telekom Albania | Vodafone Albania | Albtelecom | Plus Communication |
|---|-----------|-----------------|------------------|------------|--------------------|
| 2014 | 3,406,772 | 1,164,188 | 1,549,498 | 431,772 | 261,314 |
| 2015 | 3,442,665 | 1,127,252 | 1,611,086 | 484,350 | 219,977 |
| 2016 | 3,369,756 | 1,033,517 | 1,712,453 | 442,804 | 180,982 |
| 2017 T2 | 3,350,196 | 1,037,347 | 1,649,919 | 454,089 | 208,841 |
| 2017 T3 | 3,718,569 | 1,117,164 | 1,886,968 | 490,240 | 224,197 |
| 2017 T4 | 3,497,950 | 1,131,714 | 1,706,181 | 454,265 | 205,790 |
| 2018 T1 | 2,783,721 | 1,008,772 | 1,335,512 | 441,437 | |
| 2018 T2 | 2,615,722 | 895,050 | 1,298,454 | 422,218 | |
| | -6.0% | -11.3% | -2.6% | -4.4% | |
| Ndryshimi tremujor | | | | | |
| | -21.9% | -13.7% | -21.3% | -7.0% | |
| Ndryshim (v-m-v) | | | | | |

Tabela 3.5: Numri i përdoruesve të akses broadband në rrjetet 3G/4G sipas operatorëve

| Numri përdoruesve të celularëve me akses broadband në rrjetet 3G/4G sipas operatorëve | Total | Telekom Albania | Vodafone Albania | Albtelecom | Plus Communication |
|---|-----------|-----------------|------------------|------------|--------------------|
| 2014 | 907,975 | 225,346 | 550,196 | 132,433 | |
| 2015 | 1,297,281 | 375,973 | 706,880 | 214,428 | |
| 2016 | 1,686,354 | 460,221 | 921,854 | 231,321 | 72,958 |
| 2017 T2 | 1,823,656 | 493,162 | 947,217 | 278,610 | 104,667 |
| 2017 T3 | 2,158,739 | 541,752 | 1,178,245 | 321,083 | 117,659 |
| 2017 T4 | 2,030,978 | 613,886 | 1,030,614 | 282,077 | 104,401 |
| 2018 T1 | 1,880,265 | 616,254 | 983,990 | 280,021 | |
| 2018 T2 | 1,741,491 | 576,641 | 901,999 | 262,851 | |
| Ndryshimi tremujor | -7.4% | -6.4% | -8.3% | -6.1% | |
| Ndryshim (v-m-v) | -4.5% | 16.9% | -4.8% | -5.7% | |

Tabela 3.6: Volumi total i thirrjeve, SMS-ve, të dhëna dhe përdorimi mesatar mujor

| Volumi total i thirrjeve, SMS-ve, të dhëna dhe përdorimi mesatar mujor | Totali i thirrjeve telefonike dalëse | SMS të dërguara | Trafiku të dhëna (Gbyte) | Minuta në muaj për përdorues | SMS në muaj për përdorues | GB në muaj për përdorues |
|--|--------------------------------------|-----------------|--------------------------|------------------------------|---------------------------|--------------------------|
| 2014 | 7,201,024,035 | 1,826,346,190 | 6,006,567 | n/a | n/a | 0.55 |
| 2015 | 7,381,147,348 | 1,598,702,865 | 11,775,435 | n/a | n/a | 0.76 |
| 2016 | 1,723,638,953 | 399,641,536 | 8,357,508 | 171 | 40 | 1.65 |
| 2017 T2 | 1,691,859,892 | 369,085,481 | 10,666,508 | 168 | 37 | 1.95 |
| 2017 T3 | 1,697,497,909 | 335,163,545 | 12,384,555 | 152 | 34 | 1.91 |
| 2017 T4 | 1,577,598,735 | 333,875,225 | 13,971,859 | 150 | 34 | 2.29 |
| 2018 T1 | 1,517,831,579 | 313,921,680 | 14,995,455 | 182 | 38 | 2.66 |
| 2018 T2 | 1,549,342,161 | 314,325,201 | 14,890,032 | 197 | 40 | 2.85 |
| Ndryshimi tremujor | 2.1% | 0.1% | -0.7% | 8.6% | 6.6% | 7.2% |
| Ndryshim (v-m-v) | -8.4% | -14.8% | 39.6% | 17.3% | 9.1% | 46.2% |

Shënime:

| Treguesi | Referenca ne Formulare/Menyrë e llogaritjes | Pershkrim/Sqarim |
|---------------------------|---|---|
| Thirrje telefonike dalëse | D.11 | Thirrje telefonike dalëse të kryera nga pajtimtarët e rrjeteve celulare gjatë periudhës së raportimit. Trafiku i përfshirë në pagesa fikse llogarit minutat e kryera (reale) dhe jo vlerat nominale të ofertave/shportave. Ky tregues nuk përfshin: <ul style="list-style-type: none"> - Trafikun e pajtimtarëve të rrjeteve celulare Shqiptare gjatë kohës që ata janë në roaming ndërkombëtar. - Trafikun e pajtimtarëve të rrjeteve të huaja gjatë kohës që ata janë në roaming në rrjetet celulare Shqiptare. |

| | | |
|-------------------------------------|----------------------------|--|
| SMS të dërguara | D.13 | Numri total i SMS-ve të dërguara nga pajtimtarët e rrjeteve celulare drejt të gjitha destinacioneve, përfshirë SMS ndërkombëtare |
| Trafiku te dhena (GByte) | D.14 | I referohet sasisë së trafikut broadband të origjinuar brenda Shqipërisë nga rrjetet celulare 3G/4G ose me të avancuara. Trafiku përfshin shkarkimet dhe ngarkimet (download dhe upload) i matur në pikat a aksesit të përdoruesit fundor. Nuk përfshihet trafiku me shumicë dhe 'walled garden'. <i>Në bazë tremujore ky tregues është i disponueshëm vetëm për T4 2016, T12017 e në vijim. Më parë është raportuar vetëm në bazë vjetore.</i> |
| Minuta ne muaj per perdorues | D.11/(D.7-D.10.2)/3 | Numri i minutave të thirrjeve dalëse që një përdorues aktiv i shërbimeve telefonike celulare ka gjeneruar mesatarisht në një muaj. Llogaritet si raporti i trafikut total dalës (D7) me numrin e përdoruesve aktive të telefonisë celulare (D.7-D.10.2) dhe rezultati pjestohet me 3. Në treguesit në bazë vjetore përdoret numri mesatar i përdoruesve aktivë në fillim dhe në fund të periudhës. |
| GB ne muaj per perdorues | D.14/D.10/3 | Sasia GB e trafikut të Internetit që një përdorues aktiv i shërbimeve akses broadband celular ka përdorur mesatarisht në një muaj. Llogaritet si raporti i trafikut total të të dhënave (D14) me numrin e përdoruesve aktive të aksesit broadband celular (D.10) dhe rezultati pjestohet me 3. Në treguesit në bazë vjetore përdoret numri mesatar i përdoruesve aktivë në fillim dhe në fund të periudhës. |

Tabela 3.7: Struktura e thirrjeve dalëse celulare të origjinuar brenda vendit sipas destinacionit

| Struktura e thirrjeve dalëse celulare | Total | On-net | Off-net | Fiks kombëtar | Ndërkombëtare | Të tjera |
|---------------------------------------|----------------------|--------------------|--------------------|-------------------|-------------------|----------------|
| 2014 | 7,301,024,035 | 6,067,639,161 | 568,891,438 | 40,159,174 | 611,215,490 | 13,118,772 |
| 2015 | 7,381,147,348 | 5,110,386,598 | 1,361,510,948 | 57,369,975 | 842,887,805 | 8,992,022 |
| 2016 | 1,723,638,952 | 981,314,551 | 683,708,464 | 18,179,513 | 39,725,405 | 711,019 |
| <i>2017 T2</i> | <i>1,691,859,892</i> | <i>911,552,893</i> | <i>737,294,341</i> | <i>17,164,098</i> | <i>25,069,011</i> | <i>779,549</i> |
| <i>2017 T3</i> | <i>1,697,497,908</i> | <i>913,366,765</i> | <i>740,079,274</i> | <i>17,824,739</i> | <i>25,432,818</i> | <i>794,312</i> |
| <i>2017 T4</i> | <i>1,577,598,735</i> | <i>837,659,775</i> | <i>700,627,067</i> | <i>17,528,051</i> | <i>21,053,484</i> | <i>730,357</i> |
| 2018 T1 | 1,517,831,579 | 864,040,815 | 620,335,471 | 16,801,835 | 15,986,169 | 667,289 |
| 2018 T2 | 1,549,342,161 | 881,182,069 | 635,527,014 | 16,342,939 | 15,650,351 | 639,789 |
| Ndryshimi tremujor | 2.1% | 2.0% | 2.4% | -2.7% | -2.1% | -4.1% |
| Ndryshim (v-m-v) | -8.4% | -3.3% | -13.8% | -4.8% | -37.6% | -17.9% |

- Treguesit e tregut të shërbimeve nga rrjetet fikse

Tabela 4.1 : Numri i linjave të pajtimtarëve të telefonisë fikse

| Numri i linjave të pajtimtarëve të telefonisë fikse | Totali | Albtelecom | ASC | Abcom | Abissnet | Nisatel | OA të tjerë | Pjese tregu Albtelecom |
|---|---------|------------|--------|---------|----------|---------|-------------|------------------------|
| 2014 | 245,757 | 182,591 | 14,010 | 15,531 | N/A | 9,423 | 24,202 | 74.3% |
| 2015 | 252,739 | 180,735 | 30,670 | 12,316 | N/A | 4,828 | 24,190 | 71.5% |
| 2016 | 248,640 | 176,733 | 37,765 | 13,946 | N/A | 4,306 | 15,890 | 71.1% |
| 2017 T1 | 247,254 | 175,685 | 38,086 | 13,925 | | 4,281 | 15,277 | 71.1% |
| 2017 T2 | 245,736 | 175,005 | 39,994 | 14,355 | N/A | 3,161 | 13,221 | 71.2% |
| 2017 T3 | 245,665 | 173,788 | 41,401 | 13,879 | N/A | 3,031 | 13,566 | 70.7% |
| 2017 T4 | 247,010 | 171,516 | 42,829 | 15,282 | N/A | 2,470 | 14,913 | 69.4% |
| 2018 T1 | 255,559 | 173,392 | 43,257 | 15,130 | N/A | 2,570 | 21,210 | 67.8% |
| 2018 T2 | 247,796 | 171,716 | 43,318 | 12,234 | 4,011 | 3,753 | 12,764 | 69.3% |
| Ndryshimi tremujor | -3.04% | -0.97% | 0.14% | -19.14% | N/A | 46.03% | -39.82% | 2.14% |
| Ndryshim v-m-v | 0.8% | -1.9% | 8.3% | -14.8% | N/A | 18.7% | -3.5% | -2.7% |

Shënim: Në periudhën 2014 T4-2016 T3 përkufizimi i këtij treguesi nga AKEP ka qenë i ndryshëm nga përkufizimi actual dhe për të mundësuar krahasueshmërinë e vlerave të këtij treguesi në periudha të ndryshme kohore, vlerat e raportuara nga ASC për 2014-2016 T3 janë rivlerësuar nga AKEP dhe ASC për përfshirje në këtë tregues të të gjithë pajtimtarëve të telefonisë fikse, pavarësisht përdorimit aktiv (në 3 muajt e fundit) ose jo, siç ishte përkufizimi në 2014 T4- 2016 T3. Ky rivlerësim ka sjellë ndryshime në vlerën totale të këtij treguesi dhe pjesët e tregut të Albtelecom për periudhat e cituara.

Tabela 4.2 : Numri i pajtimtarëve me akses broadband nga rrjetet fikse

| Numri i pajtimtarëve me akses broadband nga rrjete fikse | Totali | Albtelecom | Abcom | ASC | Abissnet | Digicom | Nisatel | OA te tjere | Pjese tregu Albtelecom |
|--|---------|------------|--------|--------|----------|---------|---------|-------------|------------------------|
| 2014 | 207,931 | 82,747 | 47,480 | 28,489 | 23,259 | N/A | 9,882 | 16,074 | 40% |
| 2015 | 242,870 | 97,597 | 51,093 | 31,357 | 24,497 | N/A | 6,309 | 32,017 | 40% |
| 2016 | 266,379 | 109,851 | 52,442 | 37,650 | 29,497 | N/A | 7,421 | 29,518 | 41.2% |
| 2017 T2 | 279,424 | 113,205 | 52,195 | 41,818 | 29,197 | N/A | 7,500 | 35,509 | 40.5% |
| 2017 T3 | 287,620 | 116,181 | 53,173 | 43,488 | 30,893 | N/A | 7,910 | 35,975 | 40.4% |
| 2017 T4 | 294,654 | 120,204 | 55,860 | 46,118 | 28,633 | N/A | 7,500 | 36,339 | 40.8% |
| 2018 T1 | 314,376 | 121,144 | 58,471 | 47,041 | 28,807 | 11,903 | 8,261 | 38,749 | 38.5% |
| 2018 T2 | 320,831 | 120,885 | 59,240 | 47,992 | 30,582 | 12,724 | 8,409 | 40,999 | 37.7% |
| Ndryshimi tremujor | 2.1% | -0.2% | 1.3% | 2.0% | 6.2% | 6.9% | 1.8% | 5.8% | -2.2% |
| Ndryshim v-m-v | 14.8% | 6.8% | 13.5% | 14.8% | 4.7% | N/A | 12.1% | 15.5% | -7.0% |

Tabela 4.3 : Numri i pajtimtarëve që kanë akses në shërbime të integruara

| Numri i pajtimtareve që kanë akses në shërbime të integruara (Telefoni, Internet dhe TV) | Totali | Telefoni fikse dhe Internet | Telefoni fikse, Internet dhe TV | Internet dhe TV |
|--|---------|-----------------------------|---------------------------------|-----------------|
| 2014 | 119,230 | 78,419 | 24,330 | 16,481 |
| 2015 | 149,833 | 69,755 | 71,681 | 8,397 |
| 2016 | 186,983 | 76,045 | 92,932 | 18,006 |
| 2017 T2 | 194,285 | 77,911 | 95,328 | 21,046 |
| 2017 T3 | 198,774 | 77,541 | 98,817 | 22,416 |
| 2017 T4 | 198,483 | 81,660 | 99,888 | 16,935 |
| 2018 T1 | 211,243 | 86,525 | 101,630 | 23,088 |
| 2018 T2 | 211,059 | 87,190 | 101,895 | 21,974 |
| Ndryshimi tremujor | -0.1% | 0.8% | 0.3% | -4.8% |
| Ndryshim v-m-v | 8.6% | 11.9% | 6.9% | 4.4% |

Shënime:

| Treguesi | Referenca ne Formulare/Menyra e llogaritjes | Pershkrim/Sqarim |
|---|---|---|
| Numri i linjave të pajtimtarëve të telefonisë fikse | A.1 | <p>Ky tregues i referohet numrit total të linjave telefonike që pajtimtarët e rrejtimit fikse përdorin për shërbim telefonik fikse dhe që plotësojnë dy kushte: 1) pajtimtarit i është alokuar një numer fikse në rrjetin e operatorit (përfshirë numrat e marrë nga operatorët e tjerë me portim), dhe 2) numri fikse i alokuar është në përdorim në fund të periudhës së raportimit, pavarësisht nëse është kryer apo jo thirrje (dalese apo hyrese) gjatë periudhës nga pajtimtari. Pra ky tregues është sasia totale e numrave fikse të alokuar dhe që janë ende në përdorim nga pajtimtarët në fund të periudhës së raportimit. Këtu përfshihen edhe pajtimtarët që kanë të përfshirë shërbimin e telefonisë fikse si pjesë e paketave të integruara së bashku me shërbime të tjera si Internet, TV etj.</p> <p><i>Për periudhën 2014 T4- 2015 T3 ky tregues përfshinte totalin e pajtimtarëve me parapagim të telefonisë fikse (numri i pajtimtarëve aktivë, pra që kanë përdorur shërbimin e telefonisë fikse në 3 muajt e fundit, të paktën një thirrje hyrëse ose dalëse) dhe pajtimtarët me kontratë/paspagim ose me parapagim por që kanë paguar në avancë shërbimin (për tre muajt e fundit) të cilët konsiderohen aktivë.</i></p> <p><i>Për shkak të ndryshimit të përkufizimit në T4 2016, për të mundësuar krahasueshmërinë e vlerave të këtij treguesi në periudha të ndryshme kohore (parimi i rregullores së statistikave në pikën 6.2), AKEP ka kryer vlerësim të këtij treguesi për periudhat para T4 2016 për përfshirje në këtë tregues të të gjithë pajtimtarëve të telefonisë fikse, pavarësisht përdorimit aktiv (në 3</i></p> |

| | | |
|---|--------------|---|
| | | <i>muajt e fundit) ose jo, sic ishte përkufizimi në 2014 T4- 2016 T3. Per me shume shiko shenimin poshtë Tabelës 4.1</i> |
| Numri i pajtimtareve me akses broadband nga rrjetet fikse | B.1 | Përfshin numrin total të pajtimtareve me akses broadband fikse me shpejtësi download 256 kbit/s ose më të madhe. Ky tregues përfshin aksesin në internet me DSL, modem kabllor, fibër në shtëpi/ndërtese dhe gjithë llojet e tjera të aksesit broadband me rrjet fikse. Nuk përfshihet aksesit broadband me rrjet celular. |
| Numri i pajtimtareve qe kane akses ne sherbime te integruara (Telefoni, Internet dhe TV) | B.7 | Numri total i pajtimtarëve që kanë paketa të perbashketa (të integruar-bundles) sipas kombinimeve te mëposhteme. Paketa të integruara konsiderohen kur paguajnë nje tarifë fikse që përfshin të paktën 2 shërbime: Telefoni, Internet apo TV. |
| Telefoni fikse dhe Internet | B.7.1 | Numri i pajtimtarëve të rrjetit fikse që kanë paketë të përbashkët (dyfishe) telefoni dhe internet (pakete dyfishe), duke paguar nje tarifë që përfshin dhe pajtimin mujor për telefoni dhe për akses në Internet broadband. Nuk përfshihen pajtimtarët që përdorin telefoni dhe Internet por që kanë tarifa të vecanta mujore për dy shërbimet. Pagesa fikse mund të përfshijë ose jo minuta thirrje (falas) dhe Interneti mund të jetë me limit ose pa limit. |
| Telefoni fikse, Internet dhe TV | B.7.2 | Numri i pajtimtarëve të rrjetit fikse që kanë paketë të përbashkët (trefishe) telefoni, Internet dhe TV (IPTCV ose TV kabllor), duke paguar një tarifë që përfshin pajtimin mujor për telefoni, akses në Internet broadband dhe kanalet TV. Nuk përfshihen pajtimtarët që përdorin tre shërbimet por që kane tarifa të vecanta mujore për tre shërbimet. Pagesa fikse mund të përfshije ose jo minuta thirrje (falas) dhe Interneti mund të jetë me limit ose pa limit, si dhe kur ka pagesë ekstra për kanale TV shtesë mbi kanalet bazë TV. |
| Internet dhe TV | B.7.3 | Pajtimtarë të rrjeteve fikse që kanë vetëm Internet dhe TV, pra jo telefoni fikse. |